



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E PROFESORËVE DHE ASISTENTËVE TË ANGAZHUAR
(THIRRJE PUBLIKE" DATË 29.05.2026, Nr. 1/746)**

Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore

Lëndë/Pozitat: Grup lëndësh nga Kimia Analitike.

Komisioni vlerësues:

1. Prof. Tahir Arbneshi, Kryetar
2. Prof. Fatmir Falku, Anëtar
3. Prof. Arben Haziri, Anëtar

Kandidatët e paraqitur sipas pozitave/lëndëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rendor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitave apo kandidatëve):

Pozita/lëndët: Nr. 4. Grup lëndësh nga Kimia Analitike

1. Arbër Frangu
2. Arbër Musliu
3. Vjosa Grapci



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

SHËNIMET PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Applikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Applikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime						
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë				
1.	Arbër Frangu	Dr.	-	2		8.88	9.24		03/09/1991 (35)	-	Jo	Po
2.	Arbër Musliu	Msc.	-	2		8.59	9.00		20/12/1995 (31)	1	Jo	Jo
3.	Vjosa Grapci	Msc.	-	-		8.13	8.88		24/08/1999 (27)	-	Jo	Jo



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndën përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatit/et që propozohen për angazhim të profesorëve dhe asistentëve të angazhuar).

Nga gasja në platformën SESM konstatohet se për pozitën e shpallur kanë aplikuar katër kandidatë: (1) Blerim Haxhiu, (2) Arbër Frangu, (3) Arbër Musliu dhe (4) Vjosa Grapci. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar nga kandidatët, komisioni vëren se kandidati Blerim Haxhiu ka ngarkuar vetëm një biografi (CV) në gjuhën angleze, pa dokumentacionin tjetër të kërkuar sipas thirrjes publike. Nga të dhënat e paraqitura në CV rezultoi se formimi i tij akademik dhe profesional është në fushën e Fizikës dhe Shkencave Kompiuterike, duke mos u përputhur me profilin e kërkuar për angazhimin në grupin e lëndëve të Kimisë Analitike. Për më tepër, dosja e kandidatit nuk është e kompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në thirrjen publike. Ndërkaq, kandidatët Arbër Frangu, Arbër Musliu dhe Vjosa Grapci kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë dhe i plotësojnë kushtet formale të përcaktuara në thirrjen publike, prandaj komisioni ka vazhduar me vlerësimin e tyre sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime në Universitetin e Prishtinës.

1. **Arbër Frangu** (i lindur më 03.09.1991) është doktor i shkencave në fushën e Kimisë. Studimet universitare i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës, ku në vitin 2013 diplomoi në programin Kimi Inxhinierike me notë mesatare 8.88, ndërsa në vitin 2017 përfundoi studimet master në programin Kimi Analitike dhe Mjedisore me notë mesatare 9.24. Në vitin 2020 përfundoi edhe studimet katër-vjeçare në programin Kimi Arsimore në Universitetin e Tetovës, ndërsa në vitin 2023 fitoi gradën Doktor i Shkencave në Kimi në Universitetin e Prishtinës. Deri tani ka publikuar katër artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare me faktor impakti, prej të cilëve dy si autor i parë dhe dy si bashkautor. Ka realizuar gjashtë mobilitete shkencore në universitete e BE, përfshirë Universitetin “Karl Franzens” në Graz të Austrisë dhe Universitetin e Pardubicës në Republikën Çeke, ku ka zhvilluar një pjesë të rëndësishme të kërkimeve të tij në nivel master dhe doktoratë. Që nga viti 2016 është i angazhuar në procesin mësimor në Universitetin e Prishtinës, ku ka zhvilluar ushtrime laboratorike në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë. Krahas angazhimit në arsimin e lartë, ai ka një përvojë të gjatë edhe në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, ka ndjekur dy trajnime për mësimdhënie universitare të organizuara nga Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM) në Universitetin e Prishtinës, për të cilat është pajisur me certifikata përkatëse. Veprimtaria e tij akademike dhe profesionale karakterizohet nga angazhimi i vazhdueshëm në mësimdhënie e kërkim shkencor me fokus në fushën e kimisë analitike, mjedisore dhe elektrokimisë.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

2. **Arbër Musliu** (i lindur më 20.12.1995) është i diplomuar në fushën e Kimisë. Studimet universitare i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës, ku në vitin 2017 diplomoi në programin Kimi me notë mesatare 8.59, ndërsa në vitin 2020 përfundoi studimet master në programin Kimi Analitike dhe Mjedisore me notë mesatare 9.00. Aktualisht është student i studimeve të doktoratës në Departamentin e Kimisë në Universitetin e Prishtinës. Aktualisht disertacioni i tij ndodhet në fazën e vlerësimit në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore. Në veprimtarinë e tij shkencore, ka publikuar nëntë punime në revista shkencore të indeksuara, prej të cilave tre si autor i parë dhe gjashtë si bashkautor. Gjithashtu, ka realizuar dy mobilitete shkencore në universitete të Bashkimit Evropian, në Universitetin e Leipzigut në Gjermani dhe në Universitetin e Pardubicës në Republikën Çeke, ku ka zhvilluar aktivitete kërkimore në fushën e kimisë. Ka marrë pjesë në pesë konferenca shkencore ndërkombëtare, të organizuara në Shqipëri, Turqi dhe Sllovaki, duke kontribuar në prezantimin dhe promovimin e rezultateve të kërkimeve të tij shkencore. Që nga viti 2022 është i angazhuar në procesin mësimor në universitetet publike të Kosovës. Fillimisht ka qenë i angazhuar në Universitetin e Mitrovicës, ndërsa nga viti 2023 e tutje është bashkëpunëtor në Universitetin e Prishtinës për zhvillimin e ushtrimeve laboratorike në lëndët e kimisë në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore dhe në Fakultetin e Mjekësisë. Veprimtaria e tij akademike dhe profesionale karakterizohet nga angazhimi në mësimdhënie e kërkimin shkencor, me fokus në zhvillimin e vazhdueshëm profesional në fushën e kimisë.

3. **Vjosa Grapci** (e lindur më 24.08.1999) është e diplomuar në fushën e Kimisë. Studimet universitare i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës, ku në vitin 2021 diplomoi në programin Kimi Inxhinierike me notë mesatare 8.13. Në vitin 2023 përfundoi studimet master në programin Kimi Analitike dhe Mjedisore me notë mesatare 8.88. Gjatë formimit të saj akademik ka ndjekur trajnime dhe programe ndërkombëtare në fushën e qëndrueshmërisë dhe teknologjive moderne. Në vitin 2022 përfundoi programin “Energjia e Ripërtëritshme dhe Qëndrueshmëria” në Qendrën për Energië dhe Qëndrueshmëri të Universitetit të Prishtinës. Po ashtu, mori pjesë në Shkollën Verore Ndërkombëtare “Regional Sustainability - Smart Mobility” në Ruhr Master School of Applied Sciences në Gjermani. Në vitin 2023 realizoi një mobilitet akademik në Fakultetin e Teknologjisë Kimike të Universitetit të Pardubicës në Republikën Çeke. Në kuadër të veprimtarisë së saj shkencore, është bashkautore e një publikimi shkencor të botuar në revistën ndërkombëtare *Agriculture and Forestry*. Nga viti 2023 është e angazhuar si bashkëpunëtorë e jashtme në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e ushtrimeve laboratorike në lëndën Kimi Mjekësore. Gjithashtu, në vitin akademik 2024/2025 ka qenë e angazhuar si bashkëpunëtorë e jashtme në Fakultetin e Gjeoshkencave të Universitetit të Mitrovicës, ku ka zhvilluar ushtrime në lëndët Kimi, Kimi e Përgjithshme dhe Kimi Inorganike. Veprimtaria e saj profesionale karakterizohet nga angazhimi në arsimin e lartë, përkushtimi në punën laboratorike dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Përfundim dhe propozim:

Komisioni vlerëson se të tre kandidatët e parqitur në këtë konkurs i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime në Universitetin e Prishtinës (Rregullore Nr. 2/254, datë 17.07.2024). Megjithatë, duke marrë parasysh nivelin e kualifikimit akademik, përvojën në mësimdhënie universitare, veprimtarinë shkencore, dhe mobilitete ndërkombëtare, si dhe përputhshmërinë e ngushtë të profilit akademik me fushën e kërkuar, komisioni vlerëson se kandidati **Dr. Arbër Frangu** i plotëson në shkallën më të lartë kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. Prandaj, në mbështetje të nenit 7, pika 3 dhe 4 të Rregullores së procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime në Universitetin e Prishtinës, Nr. 2/254, datë 17.07.2024, komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit që kandidati **Dr. Arbër Frangu** të angazhohet si bashkëpunëtor i jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve në grupin e lëndëve të Kimisë Analitike, sipas Thirrjes Publike për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata dhe ushtrime, bazuar në nevojat e njëjësive akademike të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2026/2027.

Komisioni vlerësues

1. Prof. Tahir Arbneshi, Kryetar
2. Prof. Fatmir Faiku, Anëtar
3. Prof. Arben Haziri, Anëtar

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINË

Shuar me: 18/06/2026			
Org	Numër	Sasia	Vlera
01	1984	4	-

